



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al

www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202300808/2

Tiranë ____ . ____ .2023

Lënda: Rekomandim për marrjen e masave për përmirësimin e kushteve dhe të shërbimeve për fëmijët në Shtëpinë e Fëmijës 6-15 vjeç Sarandë

BASHKISË SARANDË

SARANDË

**DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT SOCIAL
SHTETËROR**

TIRANË

Të nderuar,

Në përmbushje të mandatit që institucioni i Avokatit të Popullit ka për mbrojtjen, garantimin dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve¹, po ju drejtohem nëpërmjet këtij rekomandimi, për të ndarë me Ju konstatimet e gjetjet e inspektimit, por edhe problematikat që duhen vlerësuar për t'u përmirësuar në kuadrin e detyrave dhe kompetencave ligjore të veprimtarisë suaj shtetërore.

Në zbatim të Urdhrit nr.24, datë 7.02.2023 të Avokatit të Popullit, Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve/institucioni i Avokatit të Popullit realizoi inspektim të përgjithshëm në Shtëpinë e Fëmijës "Vangjel Pulla" 6-15 vjeç, Sarandë (Shtëpia e Fëmijës Sarandë)². Shërbimet në këtë qendër rezidenciale janë ato të strehimit afatgjatë dhe të organizuar që u ofrohen kategorive në nevojë, për të cilat kujdesi në shtëpi nuk është i mundur.

¹ Bazuar në nenin 1 të Konventës e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës (1989), me fëmijë kuptohet çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç, me përjashtim të rasteve kur mosha madhore arrihet më përpara, në përputhje me legjislacionin të cilit ai i nënshtrohet.

² Vizita monitoruese është realizuar me datën 21.09.2023 në mjediset e shtëpisë së fëmijës 6-15 vjeç, Sarandë.

Vendosja e kategorive në nevojë në qendrat e kujdesit shoqëror bëhet me pëlqimin e individit ose përfaqësuesit të tij ligjor, pas vlerësimit të gjendjes shoqërore, ekonomike dhe mjekësore të individit³.

Avokati i Popullit pasi shqyrtoi informacionin nga monitorimi i realizuar, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtojë konkluzionet përfundimtare.

1. Objektivat e inspektimit:

Ky inspektim është kryer për të realizuar objektivat, si vijon:

- kontrolli i performancës së institucionit që ofron shërbime të kujdesit rezidencial për fëmijë nëpërmjet vlerësimit të dokumentacionit dhe procedurave që ndjek ky institucion.
- vlerësimi i cilësisë së punës së personelit të institucionit të përkujdesit rezidencial, shtëpia e fëmijës 6-15 vjeç Sarandë.
- vlerësimi i mjediseve dhe kushteve të institucionit.
- vlerësimi social, psikologjik, shëndetësor i përfituesve të shërbimeve të shtëpisë së fëmijës 6-15 vjeç Sarandë.
- respektimi i të drejtave të fëmijëve, në zbatim të legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar në fuqi.

2. Metodologjia e monitorimit:

Inspektimi u krye pa njoftimin paraprak të institucionit duke bazuar në këto hapa konkretë:

- **së pari**, u zhvilluan biseda paraprake me drejtuesin e këtij institucioni të përkujdesit publik rezidencial, informacion i cili u hodh në një formular standard për inspektimet e këtyre institucioneve.
- **së dyti**, u mblodhën dhe u administruan dokumentat e kërkuara nga grupi inspektues.
- **së treti**, u monitoruan dhe u inspektuan në vend kushtet materiale në të cilat jetojnë fëmijët, ambientet e përbashkëta, dhomat e gjumit, tualetet, dushet, pajisjet e hotelerisë, veshmbathjet, ushqimi, kuzhina, lavanteria, higjiena, lagështira, bombolat kundër zjarrit, ambientet e jashtme, etj.
- **Së katërti**, u zhvilluan biseda me fëmijët në institucion.

Grupi monitorues i institucionit të Avokatit të Popullit, në zbatim të ligjit organik të AP-së, kreu bisedën përmbyllëse me drejtuesin e institucionit dhe stafin në shërbim të drejtëpërdrejtë me përfituesit, të cilëve iu adresuan

³ Neni 21, i ligjit nr. 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.

problematikat e evidentuara gjatë inspektimit në Shtëpinë e Fëmijës 6-15 vjeç Sarandë.

3. Organizimi dhe funksionimi i Shtëpisë së Fëmijës 6-15 vjeç Sarandë.

a) Profili i institucionit.

Shtëpia e Fëmijës në Sarandë, si institucion rezidencial për përkujdesin social të fëmijëve 6-15 vjeç, funksionon sipas standardeve dhe procedurave të bazuara në politikat e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, sipas legjislacionit për sistemin e mbrojtjes shoqërore. Fëmijët e sistemuar në këtë institucion janë akomoduar aty për arsye të varfërisë, mungesës së mbështetjes së duhur nga familjet e tyre, si rezultat i problemeve sociale, të cilat sjellin uljen e përgjegjësisë prindërore për kujdesin ndaj fëmijëve, moskthimin e fëmijëve në familjet biologjike si rezultat i mungesës së tipologjive të reja të shërbimeve për fuqizimin e familjes.

Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë ka të përcaktuar se të drejtën për të përdorur shërbimet e kujdesit shoqëror e kanë individë ose familje që nuk kanë mjetet minimale të jetesës dhe nuk janë në gjendje t’i sigurojnë ato me punë apo të ardhura nga pronat ose burime të tjera, si dhe të gjithë individët që janë në pamundësi për të plotësuar nevojat e tyre të jetesës, vetë ose me ndihmën e anëtarëve të familjes, për shkak të kushteve personale dhe sociale. Detyrimin ligjor për fuqizimin e familjeve në kushtet e vështira social-ekonomike e ka pushteti vendor. Po kështu sipas ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, interesi më i lartë i fëmijës nënkupton të drejtën e fëmijës për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme⁴. Referuar pikës 1, të nenit 24, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”⁵, Shtëpia e Fëmijës Sarandë është në varësi administrative të Bashkisë Sarandë.

Qëllimi i këtij institucioni është ofrimi i shërbimeve rezidenciale të përkujdesit shoqëror për fëmijë duke siguruar mirëqënien fizike dhe emocionale, mbrojtje dhe siguri, zhvillim dhe integrim në jetën shoqërore, si dhe garantimin e një strehe të ngrohtë familjare në respektimin e të drejtave dhe në interesin më të lartë të fëmijës.

⁴Pika 3, e nenit 6, të ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

⁵ Kjo dispozitë përcakton se bashkitë janë përgjegjëse për krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Këto shërbime duhet të ofrohen, duke pasur parasysh disa parime bazë si:

- e drejta për të përfituar
- respektimi dhe garantimi i vlerave dhe personalitetit individual
- gjithëpërfshirja
- mosdiskriminimi
- transparenca dhe paanshmëria
- pavarësia në kryerjen e veprimeve ditore të vet fëmijëve (ushqyerja, administrimi i veshjeve dhe proceseve, rutinës normale të kujdesit personal)
- integrimi shoqëror dhe pjesëmarrje në komunitet
- barazia e mundësive
- partneriteti

b) Staf i institucionit.

Organika e Shtëpisë së Fëmijës Sarandë përbëhet nga 23 punonjës gjithsej. Organika e miratuar e institucionit përbëhet nga:

Drejtori i institucionit	1
Sektori i Shërbimit Social	
Përgjegjës Sek. Social/Punonjës social	1
Psikolog	1
Edukator	6
Kujdestar	6
Sektori i Administratës	
Përgjegjës i Sektorit të Financës	1
Kuzhinier	2
Roje	1
Punëtor Mirëmbajtës	1
Sanitar	3

Detyrat dhe përgjegjësitë e stafit, sipas pozicioneve të punës janë të parashikuara në rregulloren e brendshme të institucionit. Rregullorja e institucionit pëmban qëllimin, misionin dhe filozofinë e shërbimeve, objektivat dhe strategjinë, si dhe strukturën organizative, menaxhimin dhe administrimin, duke i dedikuar një pjesë të mirë përshkrimit të funksioneve, kompetencave dhe përgjegjësisive të personelit, si dhe të drejtave e detyrimeve të personelit dhe të përfituesve. Po ashtu, ajo përmban detaje për shërbimet e ofruara dhe procedurat e zbatimit të standardeve dhe të shërbimeve, sipas legjislacionit për sistemin e mbrojtjes shoqërore. Një element shumë i rëndësishëm, që duhet të jetë pjesë e rregullores është trajnimi në vazhdimësi i stafit, ku në një aneks të

veçantë duhet të planifikohet plani vjetor i trajnimeve të stafit. Për çdo punonjës, sipas përcaktimeve në Kodin e Punës, mbahet dosja personale me dokumentacionin përkatës⁶.

Për sa më sipër, edhe pse dosjet origjinale administrohen⁷ nga Bashkia Sarandë, të gjitha dosjet e gjendura (kopje të dokumentave origjinalë) në Shtëpinë e Fëmijës Sarandë, ishin të paplota dhe në mangësi në dokumentacion.

Referuar organikës⁸ dhe situatës faktike të vlerësuar nga grupi monitorues i AP-së, për në plotësimin e standardeve shihet mjaft i nevojshëm shtimi i organikës së këtij institucioni me një punonjëse sociale, kërkuar kjo edhe në shkresën me nr.33 prot., datë 17.03.2023 të Shtëpisë së Fëmijës Sarandë, drejtuar Shërbimit Social Shtetëror, Tiranë. Gjithashtu, në këtë institucion rezidencial, është mjaft i rëndësishëm punësimi i një mjeku, për kujdesin shëndetësor në qendër me qëllim që për çdo fëmijë të vendosur në këtë institucion rezidencial, sipas situatës fizike, emocionale dhe mendore të fëmijës, të përgatitet plani i nevojave shëndetësore.

c) Mjediset e institucionit.

Aktualisht në këtë institucion marrin shërbim 21 fëmijë (12 djem edhe 9 vajza). Ndërtesa është një godinë 3-katëshe, e amortizuar në shumë elementë të saj.

Në katin e parë ndodhet mensa, mjedisi i bollshëm, i pajisur me tavolina dhe karrige. Mensa lidhej nëpërmjet një dritareje me kuzhinën. Kuzhina është një mjedis kryesisht i pastër dhe i rregullt, me mure të sapo lyera.

Në katin e dytë të godinës, në anën e djathtë ndodhen zyrat e administratës dhe në anën e majtë ndodhen 4 (katër) dhomat e fjetjes së djemve të cilat kanë ajrim të mirë dhe janë të mirëndriçuar. Një dhomë fjetjeje ka 4 (katër) shtretër⁹, të rregullt, dhe një dollap që shtrihej në të gjithë faqen e murit të dhomës. Shqetësuse për sigurinë e fëmijëve ishte fakti se të gjitha dhomat e fëmijëve kanë dalje në tarracën e katit të parë, e cila ishte një hapsirë e madhe dhe e pa

⁶ Pjesë e dosjes janë dokumentat si më poshtë: informacion/dokumenta identifikimi (certifikatë personale me fotografi dhe familjare), *curriculum vitae* (përmbledhje e shkurtër për arsimin e kryer, kualifikimet dhe llojet e punëve që ka kryer, aktivitetet, dhe botimet apo shkrime të ndryshme të realizuara), diploma apo dëftesa e shkollës, kualifikime dhe trajnime (dëshmi apo dëftesa kualifikimi), dëshmi penaliteti, përkujdesit i punës së mëparshme, librezat e punës, librezat shëndetësore, vlerësimet e punës, kontrata e punës, vendimi i marrë nga institucioni për pranimin, 2 (dy) fotografi.

⁷ Rregullore e Brendshme, e Organizimit dhe Funksionimit të Institucionit të Institucioneve Rezidenciale të Përkujdesit Social për Fëmijë 6-15 vjeç miratuar nga Kryetare e Bashkisë, Florjana Koka me nr.200 prot., datë 25.08.2017, Sarandë.

⁸ Urdhëri i kryeministrit nr.88, datë 25.10.2011 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Shërbimit Social Shtetëror”

⁹ Sqarim, për shkak të numrit të fëmijëve në qendër, në çdo dhomë ishin të vendosur 3 fëmijë, djem, pavarësisht se dhoma përbëhej nga 4 shtretër.

siguruar me mur rrethues duke vënë në rrezik jetën e çdo fëmije. Në këtë kat ndodhet dhoma e takimit të fëmijëve me prindërit, kujdestarët/vizitorët etj. Kjo dhomë është e rregullt, e pastër, e pajisur me dy divanë, tavolinë mes, rafte me orendi të punuara nga vetë fëmijët e qendrës, një tapet dhe kondicioner. Ka një dhomë të veçantë qëndrimi dhe pushimi për djemtë, e pajisur me dy divanë dhe një TV. Ngrohja e mjediseve në stinën e dimrit realizohet me kaldajë e cila ndizet gjatë orareve të pasdites ndërsa ftohja e mjediseve realizohet me kondicioner. Në katin e tretë të godinës janë të vendosura dhomat e vajzave, konkretisht 5 (pesë) dhoma fjetjeje me nga dy shtretër, për shkak edhe të numrit të ulët të vajzave në institucion. Shtretërit janë të rregullt e të pastër, në çdo dhomë ndodhet dhe nga një dollap. Higjena e dhomave të fëmijëve si dhe e vetë fëmijëve ishte në nivelin e duhur të pastërtisë dhe mirëmbajtjes. Tualetet, përfshirë dhe dushet, pranë dhomave të djemve dhe vajzave ishin të rikonstruara, të pastra, me ujë të ngrohtë, pasi për sistemin e ujit në institucion janë të instaluar panele djellore, por tavanet e tyre ashtu si dhe gjithë muret e institucionit ishin me njolla të mëdha lagështire. Dyshemeja, dyert, dritaret, tavanet dhe elementë të tjerë përbërës të mjediseve të godinës janë të dëmtuara, të amortizuara ku kanë nevojë për ndërhyrje, riparime, lysterje si dhe zëvendësimin me pajisje të reja. Institucioni rezidencial për fëmijët duhet të jetë i zbukuruar, i mobiluar dhe i pajisur me qëllim krijimin e një mjedisi të ngrohtë, të këndshëm, familjar për fëmijët që jetojnë aty, duke i kushtuar rëndësi imazhit pozitiv dhe larmishmërisë që lidhet me gjininë, etninë, kulturën, aftësinë e kufizuar dhe seksualitetin¹⁰.

Në katin e dytë dhe të tretë ndodhen klasat e studimit të fëmijëve të ndara sipas moshës shkollore ose biologjike. Fëmijëve duhet t'u krijohen kushte për të studiuar dhe për të bërë detyrat e shtëpisë pas kthimit nga shkolla. Të gjithë fëmijët duhet të marrin mbështetje, lavdërime dhe inkurajim nga stafi i institucionit për ndjekjen e shkollës, rezultatet pozitive, studimin pas shkollës etj. Për këtë arsye nga kujdestari/punonjësi social plotësohet plani personal i arsimimit (PPA). Ndërkohë, klasat e studimit janë të pajisura me banka, karrige dhe ajër të kondicionuar. Tualetet në afërsi të këtyre klasave të studimit, ndodhen në gjendje të mjerueshme, me lagështi, lavamanet dhe cezma gjenden jashtë funksionimit normal. Uji derdhet në dysheme ose grumbullohet në kova dhe më pas derdhet në tualet, ndriçimi ishte i dobët ose mungonte, pllakat e tualetit të rena dhe pa pajisjet e nevojshme të kujdesit ndaj higjenës. Sa më sipër përbëjnë kushte të papërshtatshme për mirërritjen dhe edukimin e fëmijëve.

Në katin e parë ndodhet kutia e ankesave, e cila është e vendosur në një vend të dukshëm dhe lehtësisht të aksesueshëm. Të afishuara dhe të varura në mur

¹⁰ Pika 71 e Udhëzimit nr.830, datë 14.4.2008 "Për zbatimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për fëmijët në institucionet rezidenciale publike dhe jopublik".

gjendeshin deklarata e qëllimit të institucionit, rregullorja e institucioni, standardet e shërbimit, numrat e emergjencës së disa institucioneve etj. Institucioni është i monitoruar me kamera sigurie, por në çdo kat mungojnë fikëset e zjarrit dhe bashkalidhur me to procedurat e përdorimit të tyre. Gjithashtu mungojnë shkallët e emergjencës, sistemi i alarmit dhe një plan evakuimi nga ndërtesa në rast zjarr. Nga vëzhgimi i mjediseve të fjetes dhe klasave të studimit u vërejt se mjetet e higjenës dhe ato të vetëkujdesit të fëmijëve administrohen nga edukatorët në klasat e tyre, duke sjellë një mbingarkesë me shumëllojshmëri të materialeve personale të fëmijëve (shampoo, rroba, këpucë etj.) në këto mjedise ndërkohë që dollapet e vetë fëmijëve në dhomat e fjetjes gjenden gati të boshatisura. Mbështetja financiare realizohet nga fondet e buxhetit të shtetit nëpërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe donatorëve në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Mungesa dhe administrimi nga vetë fëmijët i pajisjeve, si shampoo, sapunë, kolinoz apo furça e dhëmbëve nuk ndihmon në krijimin e individualitetit dhe rutinës ditore të vetë fëmijëve.

d) Funksionimi dhe shërbimet e ofruara në Shtëpinë e Fëmijës 6-15 vjeç, Sarandë.

Shërbimet që ofrohen nga institucioni janë ato të **mirërritjes** së fëmijëve, duke garantuar ushqim, siguri jetese, veshmbathje, **përkujdes shëndetësor**, si dhe **shërbime psiko-sociale** (aktivitete argëtuese, informuese etj.).

Në murin e institucionit është e afishuar menuja javore e ushqimit, e ndarë sipas pesë vakteve¹¹(psh. menuja e datës 20.09.2023 ishte: në mëngjes shërbeheshin vezë të ziera dhe çaj, gjatë vaktit “zemra 1” ofrohej një banane, në drek shërbeheshin patëllxhanë të mbushur, sallatë, frut ose lëng, gjatë vaktit “zemra 2” shërbeheshin sallam dhe domate, në darkë shërbehej patate të skuqura dhe sallatë).

Është e rëndësishme që menuja, sidomos në këto institucione, të jetë e ushqyeshme, e shëndetshme, e larmishme dhe e mjaftueshme në sasi. Bazuar në dokumente të OBSH, FAO, EFSA dhe rekomandimeve kombëtare dhe ndërkombëtare të shteteve me profile të ngjashme të zakoneve dhe mënyrës së të ushqyerit, normat ushqimore ditore të propozuara për miratim sipas grupmoshave mbi bazën e të cilave rekomandohet hartimi i menuve ushqimore

¹¹ Në bazë të pikës 35 të Udhëzimit nr.830, datë 14.4.2008 “Për zbatimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për fëmijët në institucionet rezidenciale publike dhe jopublik”, Vaktet e ushqimit ofrohen në ore të caktuara në përputhje me regjimin e nevojshëm ditor të fëmijëve. Për fëmijët që e kalojnë një vakt buke, ushqimi duhet të jetë menjëherë i disponueshëm. Ndërmjet vakteve të ngrënies, fëmijëve u ofrohen ushqime të lehta, si lëngje frutash, fruta etj., të cilat mund të konsumohen edhe në ambientet e tjera të shtëpisë.

në çdo institucion që ofron vakte ushqimore të plota ose të pjesshme për fëmijët janë përllogaritur në bazë të çmimeve të artikujve kryesorë të konsumit (me TVSH) të marra nga INSTAT-Janar 2023, si dhe çmimeve të tregut.

Gjatë intervistës së realizuar me stafin e SHFSH-së, grupi inspektues i AP-së u njoh me draft-urdrin për një ushqyerje të shëndetshme me qëllim garantimin e një zhvillimi normal tek fëmijët, të dërguar nga Shërbimi Social Shtetëror, si një udhërrëfyes i qartë për të gjithë personelin e institucioneve të përkujdesit social që ofrojnë shërbime për fëmijët në nevojë, duke pasqyruar informacione të detajuara mbi ushqyerjen e shëndetshme të shoqëruara me menutë përkatëse, llojshmërinë e ushqimeve në përputhje moshën, stinët etj.

Gjatë hartimit të menysë të mbahen parasysh nevojat për ushqim në përputhje me grupmoshën dhe nevojat e veçanta të fëmijëve. Lidhur më këtë, stafi duhet të ketë njohuri për nevojat ushqimore, teknikat e ushqyerjes së fëmijëve dhe çrregullimet e të ngrënit të fëmijët e vegjël dhe adoleshentët. Kuzhina është e pajisur me pajisje frigoriferike të nevojshme për funksionimin normal të përgatitjes së ushqimit, ofrimit të ushqimit, pastrimit e pjatave, etj. Në frigorifer nuk gjendeshin provëzatat ushqimore të ditës aktuale dhe të një dite më parë.

Shërbimi Social Shtetëror, nëpërmjet komunikimit zyrtar, dërgon normat ushqimore për institucionet e përkujdesit shoqëror që ofrojnë shërbime për fëmijët në nevojë. Në përmbajtje të shkresës citohet: "...Në mbështetje të Udhëzimit nr.662 prot., datë 6.12.2022 për "Një ndryshim në udhëzimin nr.689, datë 2.10.2018 të ministrit "Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqim, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqëror", si dhe në mbështetje të urdhërit nr. 2595/1 prot., datë 10.1.2023 "Për ngritjen e grupeve të punës për hartimin e propozimeve lidhur me menunë ditore të përfituesve në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqëror, ju vëmë në dispozicion kuotat ushqimore të shpenzimeve për ushqime sipas projekt-studimit për Shtëpitë e Fëmijëve.....". Bashkangjitur shkresës zyrtare të SHSSH-së, është relacioni i përgatitur nga grupi i punës në zbatim të Urdhërit nr.465 prot., datë 01.08.2022, "Për ngritjen e grupit të punës për hartimin dhe miratimin e normës ushqimore për fëmijët 0-18 vjeç që trajtohen në "Institucionet Rezidenciale". Në këtë frymë u përcaktua masa e kuotës ushqimore për fëmijët e grup-moshës 6–11 vjeç në masën 490 lekë ndërsa për fëmijët e grup-moshës 11–15 vjeç në masën 600 lekë¹².

¹²Relacion në zbatim të Urdhërit Nr. 465, datë 01.08.2022, të SHSSH " Për ngritjen e grupit të punës për hartimin dhe miratimin e normës ushqimore për fëmijët 0-18 vjeç që trajtohen në "Institucionet Rezidenciale".Udhëzimi nr.689, datë 2.10.2018 për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqim, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqëror.

Grupi i inspektues, në funksion të inspektimit, kontrolloi dosjet e stafit dhe dosjet e fëmijëve. Dosjet e edukatorëve përmbajnë si më poshtë: deklaratën e Kodit të Sjelljes dhe përshkrimin e detyrës; planin e punës vjetor dhe mujor; relacion çdo muaj mbi aktivitetet dhe punën e realizuar, punime të vetë fëmijëve; planin individual të fëmijëve; ditar pune, si dhe Planin Edukativ Individual (PEI)¹³, për nxënësit të cilët kanë vështirësi në të nxënë. Nëpërmjet hartimit të PEI-it synohet që t'u vihet në ndihmë gjithë fëmijëve me nevoja të veçanta edukative, si dhe mësuesve e stafit tjetër mbështetës brenda institucionit rezidencial apo edhe shkollës që ndjek i mituri/nxënës, për një gjithëpërfshirje të tyre në jetën sociale dhe arsimore. Për të miturin me iniciale A.Sh¹⁴, 12 vjeç nxënës në klasën e 7 të shkollës 9-vjeçare “Adem Sheme”, u kontrollua dosja e cila përmbante PEI-in, planin e punës, fletoren e punës dhe të rezultateve. U shfletua fletorja e tij e punës ku kishte të shënuar punën në lidhje me veprimet matematikore bazike. Ai arrin të rendisë dhe të numërojë saktë numrat nga 1 deri në 10, me pak gabime numrat deri në 20, arrin të dallojë vetëm ngjyrat bazë, shkruan fjalë me rrokje, vizaton figura gjeometrike (rrethi, trekëndëshi dhe katrori) etj. Çdo edukatore aktualisht ka një grup prej 4-5 fëmijë dhe punën e tyre e pasqyrojnë në ditar ku shënojnë planin dhe aktivitetet ditore me objektiva dhe afate kohore.

Regjistri i interesimit nga familjarët e fëmijëve që ndodhen në institucion dhe ai themeltar është i plotësuar sipas rubrikave. Rezultoi që fëmijët kishin vizita të herë pas herëshme me prindërit si dhe në disa raste rezultoi që janë realizuar telefonata me fëmijët. Gjithashtu, nga vështrimi i dosjeve të fëmijëve rezultoi se në dosjen e fëmijës gjendej vlerësimi i nevojave, planin e përkujdesjes së tyre dhe raportet periodike mbi ecurinë e zhvillimit të fëmijës, formulari i vlerësimit fillestar (FID), raporti për vlerësimin e nevojave dhe ecurisë (RVNE) të hartuara dhe miratuara nga grupi multidisiplinar, pyetësor lidhur me vlerësimin e aftësive psiko-emocionale të fëmijëve, formularët e rivlerësimeve të aspekteve të ndryshme të fëmijëve të cilat janë të plotësuara sipas rubrikave përkatëse për vitin 2022-2023, relacionet mbi aktivitete të

¹³ Referuar ligjit nr.69/2012 Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, neni 65 “Organizimi i arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara” pohon: 1) “Nxënësit me aftësi të kufizuara mësojnë sipas planit mësimor e programeve lëndore të zakonshme, të përshtatura për ta, ose sipas planit mësimor e programeve lëndore të specializuara për ta”.

¹⁴ Fëmija është diagnostikuar me zhvillim intelektual jo në përputhje me moshën kronologjike, dhe ADHD. Për sa i përket zhvillimit kognitiv nuk është në parametra optimal. A.SH. ka përqendrim të ulët të vëmendjes si dhe vështirësi në të nxënë, në memorizimin dhe përpunimin e informacionit të ri. Ka aftësi të limituara për të zgjidhur probleme komplekse si dhe e ka të vështirë të qëndrojë i përqendruar për një kohë të gjatë. A.SH shfaqet me gjendje emocionale të qëndrueshme, ka vetvlërësim pozitiv dhe e shfaq atë. Ka vështirësi në menaxhimin e emocioneve të forta. Ka një zhvillim fizik konform të moshës. Për sa i përket zhvillimit social A.Sh. është një fëmijë aktiv.energjik,social,i çiltër dhe shumë i dashur me njerzit që e rethojnë. Adaptohet shpejtë dhe bëhet pjesë e grupeve sociale. Pasioni i tij është kercimi,muzika,interpretimi i personazheve televizive etj. Nuk punon dot i pavarur ka nevojë të vazhdueshme për monitorim. ***I mituri A.SH.,i kërkon vazhdimisht një familje ku ai të rritet me dashurinë prindërore që i mungon.*** Me stafin ka marrdhënie relativisht të mira.

ndryshme të realizuara me vetë fëmijët, ekzaminime mjekësore, relacione nga psikologia, vlerësimet nga edukatorët etj.. Referuar shërbimit shëndetësor çdo fëmijë ka kartelën shëndetësore pajisur me kartela vaksinimi dhe karta shëndeti. Vaksinimi i fëmijëve në këtë institucion kryhet rregullisht sipas kalendarit të vaksinave dhe grupmoshave të përcaktuara në të.

Argëtimi i fëmijëve në kohën e lirë, organizimi i veprimtarive të ndryshme social-kulturore kontribuojnë në zhvillimin e përgjithshëm të fëmijës. Interesat dhe talentet e veçanta të fëmijëve duhet të trajtohen brenda planit të kujdesit. Ky institucion kishte të miratuar planin mujor të aktiviteteve konkretisht, për muajin gusht 2023, ishin të parashikuara si më poshtë:

- Realizimi i punës në grup me fëmijët në mënyrë që të shprehin ndjenjat e tyre për të afërmit, prindërit biologjikë, kujdestaret, shoqërinë etj. Përshkrimi i eksperiencave në familje nëpërmjet vizatimeve dhe metodave të tjera përshkruese. Në këtë aktivitet do të marrin pjesë fëmijët e të gjitha grupmoshave së bashku me edukatorët.
- Përgatitja e fëmijëve të cilët do të shkojnë pranë familjes biologjike për të kaluar pushimet e verës, kjo në kuadër të forcimit të lidhjeve biologjike prind-fëmijë. Diskutimi me fëmijët për temën: "Rëndësia e familjes biologjike dhe marrëdhëniet që fëmijët duhet të kenë me familjarët e tyre. Ndjesitë që ata përjetojnë teksa kthehen pranë familjarëve të tyre"!
- Terapi në grup me fëmijët e rritur për të treguar dhe nxjerrë nga pavetëdija e tyre: eksperiencat negative të jetës së tyre, përvojat e dhimbshme dhe veprimet e pandërgjegjshme. Terapia do të ndihmojë në reduktimin e agresivitetit të akumuluar nga shtypja e përvojave të dhimbshme.
- Menaxhimi i përjetimeve, emocioneve pozitive apo negative me të cilat do të përballen fëmijët të cilët do të vazhdojnë të qëndrojnë në institucion gjatë kësaj periudhe kohore.
- Angazhimi i fëmijëve në leximin e librave jashtëshkollorë. Librat jashtëshkollorë do të shpërndahen me anë të kartelave në bibliotekën e institucionit, duke marrë parasysh preferencat e fëmijëve dhe moshën e tyre.
- Angazhimi i fëmijëve në aktivitete argëtuese të cilat ndihmojnë në zhvillimin fizik dhe stimulojnë fantazinë e fëmijëve, aktivitete të tilla si: lojërat psikosociale, pazëll, lojëra formuese, lojëra tavoline, lojëra didaktike, aktivitete sportive etj.
- Mbajta e marrëdhënieve të afërta me çdo fëmijë duke i dhënë ndihmën e nevojshme në çdo problematikë që ata përballen si dhe realizimi i bisedave këshilluese me ta.

Zhvillimi i temës "Puberteti tek vajzat" ku do të trajtohen dhe do të diskutohet mbi çështjet :

- Çfarë është faza e pubertetit?
- Çfarë i shkakton këto ndryshime?
- Ndryshimet fizike tek femrat.
- Kur fillon puberteti tek femrat?
- Çfarë ndryshimesh shfaqen tek femrat gjatë kohës së pubertetit?"

Realizimi i të tilla aktiviteteve dhe veprimtarive apo dhe të tjera si këto ka rëndësi në stimulimin e zhvillimit të fëmijëve, pasi ato ndikojnë në mirëqënien fizike, emocionale dhe sociale të fëmijëve dhe të të rinjve. Realizimi i sa më shumë veprimtarive/aktiviteteve me fëmijët ndihmon në zhvillimin e bazave të gjuhës. Futja e veprimtarive argëtuese/edukuese shërben për fitimin e vetë-vlerësimit dhe krijimit të mardhënieve ndërpersonale.

Të gjithë fëmijët e këtij institucioni frekuentojnë shkollën 9-vjeçare "Adem Sheme". Gjatë bisedës me një pjesë të fëmijëve të cilët gjendeshin në institucion, pasi pjesa tjetër po ndiqnin procesin mësimor në shkollën 9-vjeçare "Adem Sheme", u konstatua se ata janë të qetë, të kënaqur dhe me një pamje të rregullt. Ndjekja e rregullt e shkollës, është një shenjë pozitive për edukimin dhe zhvillimin e tyre personal. Fëmijët u shprehën se mjedisi, qoftë në institucionin rezidencial apo në shkollë, ofron një klimë mbështetjeje për këta fëmijë. Kujdesi i vazhdueshëm, në shkollë dhe në institucion, edukimi dhe mbështetja emocionale janë elemente thelbësore për të siguruar mirëqenien dhe suksesin e tyre në të ardhmen. Nëse ka sfida ose nevoja specifike që lindin, adresimi i tyre në kohë dhe në bashkëpunim kontribuon në atmosferën e përgjithshme pozitive për fëmijët në institucionin rezidencial. Për sa i takon moshës së fëmijëve të vendosur në këtë institucion rezidencial rezulton që:



10 fëmijë i përkasin moshës 6-10 vjeç.




11 fëmijë i përkasin moshës 11-15 vjeç.

Institucioni rezidencial i përkujdesit social për fëmijë 6-15 vjeç¹⁵, Shtëpia e Fëmijës "Vangjel Pulla" në Sarandë, strehon e jep përkujdesë për fëmijë jetim të kësaj grupmoshe, si dhe për fëmijë të ardhur nga familje me probleme

¹⁵ VKM-ja nr. 106, datë 15.2.2017, "Për një ndryshim në VKM-në nr. 425, datë 27.6.2012, "Për përcaktimin e kriterëve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale, publike dhe jopublike, të përkujdesjes shoqërore", të ndryshuar, në pikën 1 të vendimit parashikon ndryshimin e moshës së pranimit të fëmijëve në këto institucione, sipas tipologjive të caktuara të shërbimit, konkretisht: 0-5 vjeç; 6-15 vjeç dhe 16-18 vjeç.

sociale¹⁶ në pamundësi për t'u kujdesur për fëmijën e tyre. Kapaciteti i institucionit është të ofrojë shërbim për një numër prej 40 fëmijësh.

Funksionimi i brendshëm dhe organizimi i Shtëpisë së Fëmijës në Sarandë realizohet në mbështetje të rregullores së brendshme të miratuar me vendimin nr.200 prot., datë 25.08.2017, të Kryetarit të Bashkisë Sarandë, Florjana Koka, për institucionin Rezidenciale të Përkujdesit Social për Fëmijë 6-15 vjeç.



Nga analizimi i tabelës së mësipërme vihet re se 17 fëmijë janë vendosur në qendër me Vendim Këshilli Bashkiak, 9 fëmijë janë vendosur me Vendim të Komisionit të SHSSH, nga të cilët një është në proces birësimi dhe 21 fëmijë janë vendosur me Vendim të Gjykatës për Caktimin e Kujdestarisë në Institucione të Përkujdesit Shoqëror (IPSH). Nga ky numër, gjatë muajt shtator 2023, 2 fëmijë me inicialet R.S. e datëlindjes 20.12.2008 dhe A.M i datëlindjes 09.02.2012 janë transferuar në qendrën jopublike “Shpresa” të fondacionit “Shpresë për Botën”, Marikaj-Vorë. Tre fëmijë të tjerë, konkretisht, Q.Xh., i datëlindjes 01.03.2008, M.M., i datëlindjes 09.07.2008 dhe R.T., i datëlindjes

¹⁶ Ligjin Nr. 121/2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë"; Ligjin nr. 18/2017 "Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve"; VKM nr. 658 datë 17.10.2005 "Për standartet e Shërbimeve Shoqërore"; VKM nr. 659 datë 17.10.2005 "Për standartet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror për fëmijët në institucionet rezidenciale"; VKM nr. 518 datë 04.09.2018, "Për kriteret e vendosjes në institucione rezidenciale të përkujdesit shoqëror dhe dokumentacionin e nevojshëm për pranim si dhe masën për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit"; VKM nr. 106 datë 15.02.2017 "Për kriteret e vendosjes në institucione rezidenciale të Përkujdesit Shoqëror dhe dokumentacionin e nevojshëm për pranim" - i ndryshuar.

24.03.2008, janë transferuar në Shtëpinë e Fëmijës 15-18 vjeç Shkodër nëpërmjet Proces-Verbalit me nr.116 prot., datë 01.09.2023. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe është bërë i mundur kthimi në familjen biologjike i të miturit Xh.A., me datëlindjes 17.03.2008 nëpërmjet vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë me nr.23-2023-915(348).

Nisur nga sa më sipër rezulton se vetëm një fëmijë është kthyer në familjen biologjike. Padyshim kohëzgjatja e proceseve gjyqësore ndikon në këtë drejtim, pasi gjykatat marrin një kohë të konsiderueshme për t'u shprehur me vendim për qëndrimin apo rikthimin në familje të fëmijëve të pranuar si raste emergjente. Nga ana tjetër strukturat vendore duhet të punojnë më shumë për fuqizimin e familjeve të këtyre fëmijëve. Shumica dërrmuese e rasteve të kujdestarisë janë ato me lidhje gjaku, ndërsa numri i fëmijëve të vendosur në kujdestari alternative pa lidhje gjaku është krejt i papërfillshëm. Deri në fund të vitit 2021, asnjë nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVV) nuk ka rezultuar të ketë hartuar dhe miratuar listën e familjeve kujdestare pa lidhje gjaku¹⁷.

Autoritetet përgjegjëse duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet për të fuqizuar familjet, për rritjen dhe mirërritjen e fëmijëve ose ofrimin e mundësive të kujdesit alternativ. Institucioni duhet të jetë alternativa e fundit për qëndrimin dhe rritjen e tyre. Është më se e evidente rëndësia e fuqizimit të sistemit të integruar për mbrojtjen e fëmijëve dhe zbatimit të planeve konkrete për ngritjen, financimin dhe funksionimin e shërbimeve mbështetëse për fëmijët dhe familjen pasi mungesa e këtyre shërbimeve faktohet edhe nga tabela e mëposhtme ku përcaktohet kohëqëndrimin i fëmijëve në institucion.

Nr.	Emër, mbiemër të fëmijës	Data e lindjes së fëmijës	Data e hyrjes në institucion Shtëpia e Fëmijës, Sarandë
1	A. Sh	29.08.2011	29.03.2017
2	A. M.	24.09.2013	10.09.2019
3	A. G.	27.12.2021	31.01.2022
4	A.S.	29.03.2014	09.09.2020
5	B. Sh.	17.05.2015	30.09.2021
6	C. H.	30.10.2013	09.09.2021
7	E. H.	30.09.2009	26.06.2019
8	E. M.	23.12.2011	07.09.2019
9	F. S.	06.03.2012	07.09.2019
10	J. G.	05.10.2009	06.09.2016
11	K. G.	31.12.2010	12.11.2018
12	L. M.	04.08.2015	30.09.2021
13	M. M.	01.05.2014	22.07.2021
14	N. M.	19.03.2013	22.07.2021

¹⁷ <https://www.unicef.org/albania/media/4391/file/AKDF%202021-2026%20ALB.pdf>, parag.1, faqe 26.

15	O.D	27.12.2012	07.03.2019
16	S.D	20.11.2010	07.03.2019
17	XH.H	22.10.2015	30.09.2022
18	Xh.B	20.04.2013	10.09.2019
19	S.T	10.07.2015	23.12.2022
20	A.H	24.07.2009	27.01.2023
21	M.R	05.05.2014	28.07.2023

Mbrojtja e të drejtave të fëmijës nis që në familje, nga prindërit, ndaj për të parandaluar dhe pakësuar rrisqet e mundshme me të cilat mund të përballen fëmijët dhe për t'i pajisur prindërit me aftësitë përkatëse jo të dhunshme proaktive për të rritur fëmijët, prindërit kanë nevojë për mbështetje nga institucionet e pushtetit vendor, si dhe nga aktorë të tjerë, që janë pjesë e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës. Ndërhyrjet dhe shërbimet duhet të bazohen mbi nevojat, sidomos atyre specifike të fëmijës dhe familjes, si dhe duhet të jenë të përshtatura për fëmijën.

Kjo, në frymën e Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijës, si dhe të legjislacionit për mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijëve, konkretisht ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” dhe ligjit nr.121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, të cilët, ndër të tjera garantojnë të drejtën e fëmijës për ofrimin e shërbimeve mbështetëse, në rastet kur fëmijët mbeten jashtë këtij përkujdesi për faktorë natyralë, socialë apo ligjorë. Ndaj, duhet të vijojë puna dhe përpjekjet nga organet e administratës shtetërore për ngritjen e shërbimeve të përkujdesit shoqëror për fuqizimin e familjeve dhe krijimin e familjeve kujdestare pa lidhje gjaku në të gjitha njësitë e vetqeverisjes vendore për të larguar fëmijët nga institucionet.

Avokati i Popullit ka ndërgjegjësuar ndërmarrjen e të gjitha veprimeve nga autoritetet shtetërore për të respektuar, mbrojtur dhe përmbushur të drejtat e fëmijës, në mënyrë që fëmijët dhe të rinjtë, pa dallim, të gëzojnë të drejtat e tyre. Në këtë frymë, këto të drejta themelore dhe të patjetërsueshme shkojnë paralelisht edhe me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (konkretisht objektivat 3 dhe 10.2), të cilat theksojnë rëndësinë e sigurimit të një jetese të shëndetëshme dhe promovimit të mirëqenies për të gjithë në të gjitha moshat, si dhe uljen e pabarazisë, duke fuqizuar dhe promovuar përfshirjen sociale dhe ekonomike të të gjithëve, pavarësisht nga mosha, gjinia, aftësia e kufizuar, raca, etnia, origjina, feja apo statusi ekonomik ose ndonjë status tjetër. Avokati i Popullit është një nga aktorët e angazhuar për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut, të cilat përbëjnë edhe bazën e konceptimit të këtyre të drejtave.

Në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës,

në interesin më të lartë të tyre dhe, në zbatim të legjislacionit të mbrojtjes së fëmijës, institucioni i Avokati i Popullit, në mbështetje të nenit 21, të ligjit nr.8454, datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar,

REKOMANDON:

- Marrjen e masave të menjëhershme nga Bashkia Sarandë, për kryerjen e ndërhyrjeve për përmirësimin e mjediseve të godinës, konkretisht izolimin dhe rrethimin e tarracës së godinës, shmangien e lagështirës në muret e saj riparimin e dyshemesë, dyerve, dritareve dhe tavaneve si dhe zëvendësimin me pajisje të reja aty ku është e nevojshme.
- Marrjen e masave nga Bashkia Sarandë për sigurimin e godinës me të gjithë elementët e parashikuar në Standardet për Mbrojtjen nga Zjarri, dhe vendosjen e një sistemi alarmi bashkangjitur me një Plan Evakuimi.
- Marrjen e masave nga Shtëpia e Fëmijës Sarandë për vendosjen e provëzave/kampioneve ushqimore ditore me shënimin e datës përkatëse.
- Marrjen e masave nga Shtëpia e Fëmijës Sarandë për plotësimin e dosjeve të personelit (si psh. raporti i lëshuar nga komisioni mjekoligjor, konfirmimi për kryerjen e kontrollit mjekësor bazë, formulari i vlerësimit periodik të punës së punonjësve, dëshmia e penaltetit etj.) me dokumentacionet e nevojshme të përcaktuara edhe në Rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të institucionit.
- Marrjen e masave nga Bashkia Sarandë për evidentimin e familjeve kujdestare për fëmijët në nevojë, duke përfshirë shtimin e ndërëgjegjësimit të publikut për ofrimin e shërbimit të kujdestarisë (me qëllim rritjen e numrit të familjeve pa lidhje gjaku që ofrojnë shërbimin e kujdestarisë), si dhe për ndikimet negative që ka në zhvillimin e fëmijës vendosja afatgjatë në institucionet e përkujdesit social rezidencial.
- Marrjen e masave nga Bashkia Sarandë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social me qëllim punësimin në institucionin Shtëpia e Fëmijës Sarandë të një punonjësi social dhe të një mjeku me kohë të pjesshme.

Në mbështetje të nenit 22, të ligjit nr. 8454 datë 4. 2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, organet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar

rekomandime, duhet t'i shqyrtojnë ato dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit.

Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin dhe, në vijim të bashkëpunimit, ndërmjet institucioneve tona, në frymën e legjislacionit të mbrojtjes së fëmijës, bashkërendimit dhe koordinimit ndërsektorial në nivel qendror dhe vendor, si dhe në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, lutemi shqyrtimin e këtij rekomandimi.

Me respekt,

K O M I S I O N E R

Olta ALIAJ